

AKTI I THEMELIMIT
te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara
"ALMOD" SH.P.K.

Sot me date 17 dhjetor 1994 para meje Milto Dado noter ne qytetin e Durresit u paraqiten :

1- Hamdi Hoxha i biri i Mustafait dhe i Zelihase i lindur ne 25.06.1943 banues ne Logja 1 Rruga Q. Stafa Durres me nr. Pashaporte UG 226520 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Durres jo per vehte por si perfaqesues i " NDERMARRJES SE KEPUCEVE 2 TE GOMES DURRES " Ndermarrje Shtetore me te drejta Shqiptare me qender ne Durres Shkozet Rruga Bajram Tusha, ne vazhdim e quajtur " N&K2G " ; i pajisur me prokure qe i bashkangjitet nen germen A, identitetin e te cilit e verifikova me leter njoftimi nr. UG 226520.

2- Paolo Gennari biri i Tinos dhe i Erme Guglielmetti lindur ne Conegliano TV me 16/07/1949, banues ne Rome Rruga S. Roberto Bellarmino n. 6 me pashaporte n. 235952 G leshuar nga kuestura e Padoves me nenshtetesi italiane, jo per vehte por si perfaqesues i firmes SIMOD S.p.A. me seli legale ne Rr. verdi Nr. 14 35020 S. Angelo di Piove di Sacco (PD) Itali, ne vazhdim e quajtur "SIMOD", identitetin e te cilit e verifikova me Pashaporte Nr. 235952G. i pajisur me prokure qe i bashkangjitet nen germen B

te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote nenshkruan aktin e themelimit te Shoqerise si me poshte:

NENI 1

Te krijone ne kuptimin e ligjit 7638 dt 19/11/1992, me ndryshimet perkatese nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te quajtur me emrin ALMOD SH.P.K. me qender ne Durres, Shkozet Rr. Bajram Tusha, qe me poshte do te quhet thjesht Shoqeri.

NENI 2

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar dhe veprimtaria rregullohet pervec se me anan e kesaj kontrate ashtu dhe me dispozitat ligjore qe rregullojne shoqerite me pergjegjesi te kufizuara si dhe nga statuti i perbere nga 25 nene nenshkruar nga palet dhe nga une noteri, i cili i bashkangjitet kesaj kontrate nen germen C dhe eshte pjese perberese dhe thelbesore e saj, qe palet me deklaruan se e miratojne me unanimitet.


NENI 3

Objekti i Shoqerise eshte:

- te veproje ne fushen e fabrikimit te kepuceve dhe te artikujve te tjere sportive dhe artikujve per kohen e lire, komponenteve dhe aksesoreve,
 - ne projektimin dhe studimin e impianteve per prodhimin e kepuceve dhe artikujve sportive dhe komponenteve dhe aksesoreve te tyre,
 - ne dhenje asistence teknike Know-How ne studimin e tregut dhe tregtimit te prodhimeve.
- Shoqeria do te kete nje kapacitet prodhues prej 600.000 pale kepuce dhe cizme ne vit dhe 600.000 pale faqe ne vit. Ne vecanti Shoqeria do te jape asistence per te realizuar ne teritorin e Republikes se Shqiperise per prodhimin e kepuceve dhe artikujve te tjere sportive dhe per kohen e lire, si dhe per realizimin e projekteve te konstruksioneve te ex-novo dhe ristrukturimin e tyre, te beje studime dhe te jape teknologji, asistence dhe drejtimin duke siguruar tregtimin qofte per sherbime financiare te pasurise se paluajteshme dhe te luajteshme te nevojshme.

NENI 4

Kozezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar mbi 10 vjet nga data e regjistrimit prane Gjykates se Tiranës.
Nje vit para skadimit me aprovimin unanim te ortakeve palet mund te vendosin per zgjatjen e kohes.



NENI 5

Kapitali shoqeror eshte caktuar ne lek 100.000 (njeqind mije), nenshkruar nga c'do ortak sipas kuotave te poshteshenuara :

1- SIMOD-i nenshkruan nje kuote prej 19.000 (nentembdhjetemije) Leke baraz me 19% te kapitalit shoqeror

2- N&K2G nenshkruan nje kuote prej 81.000 (tetedhjete e nje mije) Leke baraz me 81% te kapitalit shoqeror.

Kapitali shoqeror i nenshkruar perbehet nga 100 kuota te pandashme me vlere nominale 1000 Leke secila qe sebashku arrijne ne shumen 100.000(njeqindmije) Leke.

Kapitali i mesiperme eshte depozituar i gjithi simbas ligjit prane noterit Milto Dado sic vertetohet nga dokumenti i leshuar nga banka qe i bashkangjitet kesaj praktike me germen D.

Kapitali shoqeror mund te ndryshoje sipas kerkesave te Shoqerise, nga asamblea e ortakeve, ne baze te kontratave ndermjet tyre te bera konform normave te statutit dhe dispozitave ligjore.

Kapitali shoqeror i nenshkruar dhe i derdhur respektivisht nga c'do ortak, do te regjistrohesh ne llogarine e Shoqerise dhe c'do ortaku do ti jepet nje vertetim si deshmi e kuotes se derdhur prej tij ne Shoqeri.

NENI 6

Shoqeria ka te drejte te kete llogari ne banka te ndryshme Shqiptare ose te huaja sipas legjislacionit Shqiptar dhe mund te disponoje lirisht mjetet monetare te grumbulluara.

NENI 7

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pasi jane kontabilizuar detyrimet ndaj te treteve, pas heqjes te rezerves ligjore dhe likuidimit te gjitha detyrimeve tatimore ne masen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar, ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuoten e kapitalit shoqeror qe zoteron dhe qe ka derdhur.

Fitimi qe i perket Siomdit mund te transferohet jasht shtetit Shqiptar simbas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 8

Veprimtaria e Shoqerise mbyllet me 31/12 te c'do viti dhe bilanci duhet te aprovohet brenda gjashte muajve pasardhes. Me marreveshje ndermjet paleve mund te jene te kryera bilance ne mes te vitit simbas kerkesave.

NENI 9

Aktiviteti ekonomik i Shoqerise dhe investimet e ortakut italian SIMOD ne kete Shoqeri mbrohen nga legjislacioni shqiptar i cili garanton te njejtat kushte qe gezojn dhe personat juridik shqiptar.

NENI 10

Ortaket dhe administratoret jane te detyruar te ruajne te fshehten e dokumentacionit, te informacionit, njohurit dhe eksperiencen e shkembyer dhe realizuar ne kuadrin e Shoqerise dhe te marrin masat e nevojshme per evitimin e perhapjes qofte dhe ne menyre te pjeseshme.

Ortaket administratoret jane pergjegjes per pasojat e demshme shkaktuar nga shkeljet e detyrimeve te mesiperme dhe per demet e shkaktuara me dashje ose nga pakujdesia.

NENI 11



Asnje nga administratoret nuk ka te drejte te ushtroje aktivitet qe te konkuroje me ate te Shoqerise per llogari te tij ose per te tretet ose te marrin pjese si ortak.

Me pergjegjesi te kufizuara me shoqeri te tjera konkurrese me perjashtim te rasteve te autorizuar me shkrim nga asamblea e ortakeve.

NENI 12

DETYRIMET E SIMOD- it

SIMOD-i detyrohet te plotesoje me korrektesi dhe sipas mirebesimit me Shoqerine, kontratat e furnizimit te makinerive, licencat e Know-How, licencat e markes dhe kooperimitashme te hartuara me N&G dhe te kontriboje se bashku me Shoqerine ne realizimin sa me siper, te marrin pjese ne organizimin dhe drejtimin e prodhimit te Shoqerise, te kotribuojne me N&K2G ne prodhimin e Shoqerise me sasine dhe cilesine e percaktuar ndermjet paleve. Te ndjeke kur ti kerkohet kualifikimi i personelit te Shoqerise





NENI 13

DETYRIMET E N&K2G

N&K2G detyrohet t'i dorëzojë Shoqërisë pasuritë e palujtëshme dhe të lujtëshme, materialet, makinerit dhe instalimet e nevojshme për aktivitetin e Shoqërisë, gjithashtu të sigurojë fuqinë punëtore, përfshirë këtu edhe personelin tekniko-administrativ të Shoqërisë, të kontribuojë së bashku me Shoqërinë në realizimin e kontratës të licencës të Know-How, të furnizimit të makinerive, të licencës së markës, kooperimit, të marrë pjesë në organizimin dhe drejtimin e prodhimit të kontribuojë me Simodin në prodhimin e Shoqërisë me çilesinë dhe sasinë e përcaktuar ndërmjet paleve.

NENI 14

ZGJIDHJA

Pa cenuar normat dhe ligjet në fuqi, secila nga palët mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës nëse njëra nga palët nuk plotëson detyrimet e parashikuara dhe nuk i plotëson ato brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga lajmërimi me shkrim i palës tjetër.

Kontrata mund të zgjidhet për shkakë ligjore të falimentimit, për paafësi paguese.

Së fundi kontrata mund të zgjidhet sipas ligjes, pa cenuar të drejtat që i perkasin SIMOD-it në bazë të kontratës dhe kontratave të hartuar nga Shoqëria në rast se hyjnë në fuqi në Rep. e Shqipërisë dispozitat ligjore që kufizojnë ose demtojnë investimet e operuara nga vet SIMOD-i.

Në rastet e parashikuara nga paragrafet e mësipërme, pala kontraktuese e interesuar ka të drejtë të komunikojë me shkrim palës tjetër të verifikojë shkaktun e zgjidhjes, skadencat, pushimi i efekteve dhe ose zgjidhjes së kesaj kontrate, për ç'fardo arsye, do të përcaktojë të drejtën e zgjidhjes së kontratës, të licencës së markës dhe kooperimit.

NENI 15

FORCA MADHORE

Palet nuk kanë përgjegjësi për mosqenien korrekt në plotësimin e detyrimeve në rastin e forcave madhore si zjarre, terrate, revolta popullore etj. Për palën që për arsye të forcave madhore ka qenë e pa mundur të plotësojë detyrimet, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim palën tjetër për fillimin dhe mbarimin e shkakut.

Certifikatat e lëshuara nga organet kompetente shtetërore të vendit e për palën e interesuar konsiderohen prova të mjaftueshme për ekzistencën dhe për pushimin e shkakut të mësipërm të forcave madhore. Në qoftëse shkakun i forcës madhore që i referohet njëra nga palët zgjat me shumë se tre muaj, pala tjetër është e autorizuar të pezullojë plotësimin e detyrimeve që lindin nga kjo kontratë dhe të kërkojë zgjidhjen.

NENI 16

ARBITRAZHI

Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin midis paleve kontraktuese, ose midis tyre dhe Shoqërisë, të cilat nuk zgjidhen me rrugën e bisedimeve do të zgjidhen me arbitrazh në gjykatën e rrethit Durres sipas ligjeve Shqiptare.

Palet detyrohen t'a konsiderojnë vendimin e këtij arbitrazhi definitiv dhe të pa apelueshem dhe t'a ekzekutojë atë plotësisht.

NENI 17

KOMUNIKIMI

C'do komunikim ose njoftim për t'i dhënë fuqi kontratës, përfshirë dhe procedurat arbitrare, duhet të bëhet me adresat dhe numrat e poshtëshënuar:

A) SIMOD S.p.A

Via Verdi Nr.14

35020 S.Angelo di Piove di Sacco (Padova) Italia

Tel. 0039-49-9790101 fax 0039-49-9790133 telex 4300228 SIMOD I

B) NDERMARRJA E KEPUCE 2 GOMA

Rruga Bajram Tusha

Shkozë Durres Shqipëri

tel. 355-52-23101 fax 355-52-23101

C'do ndryshim adrese duhet të njoftohet me shkrim.

NENI 18

I gjithë dokumentacioni i Shoqërisë, nën kujdesin e administratorëve kompetentë, duhet të ketë bashkangjitur përthimin në italisht të kryer në të njëjtën kohë që merret dokumenti.

NENI 19

Kjo kontrate u hartua ne dy gjuhe : ne shqip dhe ne italisht, vertetuar nga noteri.
Ne rast keqkuptimi lidhur me interpretimin ose perkthimin, teksti ne shqip do te jete ai perfundimtar.

NENI 20

Kontrata, pasi u hartua u lexua ne prani te perfaqesuesve te ortakeve dhe nepermjet te cileve, nenshkruhet me vullnetin e lire te tyre.

ORTAICET

per NDERMARJA E KEPUCEVE 2 TE GOMES DURRES


per SIMOD S.p.A.

.....
Hamdi Hoxha

.....
Paolo Gennari

NOTERI

.....
Milto J. Dado



**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALMOD" SH.P.K.**

me qender ne Shkozet Durres Republlka e Shqiperise

Sot me date 17.12.1994 para meje Milto J Dado noter ne qytetin e Duresit u paraqiten :

- 1)- Hamdi Hoxha i biri i Mustafait dhe i Zelihase i lindur me 25.06.1943 banues ne Lagjen 1 Rruga Q.Stafa n.2 Durres me Nr. Pashaporte UG 226520 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Durres jo per vehte por si perfaqesues i " NDERMARRJA E KEPUCEVE 2 TE GOMES DURRES " Ndermarrje Shteterore me te drejta Shqiptare me qender ne Durres Shkozet Rruga Bajram Tusha, ne vazhdim e quajtur "N&K2G", i pajisur me prokure qe i bashkangjitet nen germen A, identitetin e te cilit e verifikova me leter njoftimi nr. UG 226 520
- 2)- Paolo Gennari i biri i Tinos dhe i Erme Gugliemelli lindur ne Conegliano TV me 16.07.1949, banues ne Rome Rruga S.Roberto Bellarmino n.6 me pashaporte n. 239552G leshuar nga Kuestura e Padoves me nenshtetesi italiane, jo per vehte por si perfaqesues i firmes "SIMOD S.p.A." me qender ne Padova Rruga Verdi nr. 14 35020 S.Angelo di Piove di Sacco (PD) Itali, ne vazhdim e quajtur "SIMOD", identitetin e te cilit e verifikova me pashaporte nr. 239552 G i pajisur me prokure qe i bashkangjitet nen germen B, te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote rane ne marreveshje si me poshte :

**KREU I 1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

NENI 1

Pjesetaret e shoqerise jane :

- 1) NDERMARRJA E KEPUCEVE 2 TE GOMES DURRES
Rruga Bajram Tusha Shkozet Durres Shqiperi
- 2) SIMOD S.p.A
Via Verdi nr. 14 35020 S. Angelo di Piove Padova Italia

NENI 2

Shoqeria eshte pagezuar me emrin " A L M O D " SH.P.K . Eshte person juridik Shqiptar. Ajo fiton te qenit si person juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe ketij Statuti dhe ne kontratat ndermjet ortakeve

NENI 3

Shoqeria e ka qendren ne rrugen Bajram Tusha Shkozet Durres dhe mund te hape filiale dhe dege te tjera ne Shqiperi dhe jasht saje. Njesit strukturore, deget dhe perfaqesit do te ndertohet ne konformitet me legjislacionin Shqiptar dhe me ate te vendeve te jashtme ku ajo do te kete qender.

NENI 4

Shoqeria themelohet per te operuar ne fushen e fabrikimit te kepuceve dhe komponenteve te tyre dhe ose aksesoreve ne dhenje ndihme teknike e Know- How te studimeve te tregut dhe tregetimin e prodhimeve ne Shqiperi dhe jashte saj. Shoqeria do te kete nje kapacitet prodhues 600.000 pale kepuce ne vit dhe 600.000 pale tomaie ne vit. Ne vecanti Shoqeria do te siguroje gjith te tregetimin qofte per importimin e sherbimit te makinerive dhe teknologjise, qofte per eksportimin dhe tregetimin e prodhimeve, te jape ndihmen e pregatitjes personelit dhe kurse kualifikimi. Si rrjedhoje Shoqeria per realizimin e qellimit te saje do te zhvilloje gjith aktivitetin industrial tregtar, sherbimi, financiar te pasurive te luajteshme ose te pa luajteshme te nevojshme. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe ne konformitet me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar te miratuara nga Asambleja e ortakeve.

Hoxha

Paolo Gennari

NENI 5

Pjesmarrja ne Shoqeri nuk pengon pamvarsine ligjore, organizative dhe te pronesis se ortakeve. Ortaket qe marrin pjese ne Shoqeri nuk jane pergjegjies per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit industrial dhe tregetar te Shoqerise me tej kapitalit themeltar te Shoqerise qe ata kane nenshkruar, gjithashtu Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te vet.

NENI 6

Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar mbi 10 vjet nga data e regjistrimit prane Gjykates se Tiranës. Nje vit para skadimit me aprovimin unanım te ortakeve, palet mund te vendosin per zgjatjen e kesaj kohe.

NENI 7

Shoqeria do te kete vulen e saje me forme drejtkendeshe ku shkruhet : Shoqeria me pergjegjiesi te kufizuar ALMOD Shkozet Durres.

KREU I 2
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

NENI 8

Kapitali shoqeror fillestar i Shoqerise eshte 100.000 Leke dhe eshte i ndare ne 100 kuote me vlere nominale nga 1000 Leke secila. Ky kapital eshte depozituar prane noterit Milto Dado Durres.

Kuotat jane te ndara ne kete menyre :

- A) per 81 kuota baraz ne lek 81.000(tetedhjete e nje mije) per N&K2GD. barabart me 81%.
- B) per 19kuota baraz me 19.000(nentembedhjete mije) per SIMOD S.p.A barabart me 19 %.

Kapitali do te ndryshohet ne baze te kontratave ndermjet ortakeve.

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 9

Menyra dhe skadenca e derdhjes te kuotave te kapitalit themeltar, jane fiksuar ne nenin 40 te ligjit nr. 7638 dt. 19/11/1992 qe qysh tani i jep mandatin z. hamdi Hoxha me Nr. pashaporte UG 226520, deri sa te terheqe fondet sic eshte parashikuar nga neni 41 i ligjit 7638.

NENI 10

Ortaket brenda 10 diteve nga regjistrimi i Shoqerise prane Gjykates Tirane, do te ndjekin impenjimet e marra me kontraten e 16.12.94, ne rast kundert Shoqeria do te zgjidhet ne menyre te menjehershme.

NENI 11

Kuotat jane lirisht te transferueshme kur :

- personat fizik, ne ruge trashegimie dhe ne rast bashkndarje te pasurive ndermjet bashkshorteve dhe ndermjet brezit te meparshem dhe atij pasues.


- personi juridik, brenda Shoqerise ne perkatesi te personit juridik titullar (grup).

Ne rastet e tjera transferimi i kuotave kerkon lejen me shkrim te shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e kapitalit shoqeror, precedenca e transferimit te pronesis se kuotave nominative u takon ortakeve te tjere te Shoqerise ne perpjestim me kuoten e kapitalit qe zoteron me te njejtin cmim te afruar.

C'do ortak ka te drejten te largohet nga Shoqeria duke njoftuar vendimin e tij organit administrativ nje vit me pare, duke specifikuar dhe te drejten e opsionit.

Largimi nga Shoqeria nuk e shkarkon ortakun nga detyrimet financiare te meparshme qe ka marre ndaj Shoqerise dhe po ashtu nuk nderpret detyrimet qe ka Shoqeria ndaj ortakut.

KREU I 4
ADMINISTRIMI I SHOQERISE KOMPETENCAT ADMINISTRATORE





NENI 12

Administratori ose (administratoret) janë persona fizik që ushtrojnë funksionet e tyre nën kontrollin e asamblese së ortakëve.

Administratoret emerohen nga Asamblea e ortakëve me votim të favorshëm të shumicës së thjeshtë të kapitalit shoqëror.

NENI 13

Administratoret qëndrojnë në detyrë për 5 (pese) vjet me përjashtim të revokimit nga asamblea e ortakëve me shumicë të thjeshtë të kapitalit shoqëror.

Ata kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të Shoqërisë me përjashtim të rasteve të vecanta, të percaktuara eventalisht nga asamblea e ortakëve.

NENI 14

Administratoret në tërësi të tyre krijojnë marrëdhënie sipas kompetencave të tyre specifike.

Një ose më tepër ortakë që përfaqësojnë, individualisht ose në grup të pakten 1/10 e kapitalit shoqëror, mund të kërkojnë një raport mbi një ose disa pika të aktivitetit të kryer nga administratoret.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të tjerëve në proceset gjyqësore, arbitrazhi, disponon pasuritë, dhe mbron interesat e Shoqërisë me përjashtim të kompetencave të vecanta që rezervon asamblea e ortakëve.

Kufizimet e kompetencave të administratoreve të percaktuara nga asamblea e ortakëve u behen të njohura të tjerëve nëpërmjet depozitimit të shkresës që e ka leshuar pranë Gjykatës së Tiranës dhe janë të vlefshme kundrejt të tjerëve që duhet t'ia respektojnë.

Sidoqoftë Shoqëria nuk përgjigjet ndaj të tjerëve, nëse mund të demonstron që ata i dinin kufijt e kompetencave të administratoreve ose të objektit shoqëror.

NENI 15

KONTRATA E NDALUARA

Administratoreve dhe ortakëve u ndalohet, me përjashtim të konsensusit me shkrim të shprehur me unanimitet nga asamblea e ortakëve, të marrin hua, të garantojnë ose të kreditojnë të tretet e ç'do forme qoftë kjo, në të kundërt kjo kontratë është pa vlerë (null).

Kjo masë vlen edhe ndaj ortakëve, administratoreve, përfaqësuesve ligjorë nga bashkshortet dhe ç'do person tjetër.

NENI 16

PERGJEGJESIT LIGJORE E ADMINISTRATIVE

Administratoret janë përgjegjës individual ose solidar, sipas rasteve ndaj Shoqërisë ose ndaj të tjerëve për rastet e shkeljes së ligjit dhe statutit, ose për gabimet e kryera për faj ose pakujdesi gjatë administrimit të Shoqërisë.

KREU 5

ORTAKET

NENI 17

Asamblea e ortakëve është organi më i lartë i Shoqërisë.

Vendimet e marra nga asamblea e ortakëve regjistrohen në librin e proces verbaleve të asamblese dhe zbatohen nga administratoret e ngarkuar.


NENI 18

Asamblea e ortakëve mund të kryejë në ç'do moment që ajo e gjykon të pershtatshëm verifikime ose kontrole duke kërkuar dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë së saj.

ASAMBLEA E ORTAKEVE

- Emeron dhe shkarkon administratoret, si dhe percakton kufijt e kompetencave.
- Vendos për zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.
- Merr vendime mbi veprime juridike të Shoqërisë dhe ngarkon administratoret për ekzekutimin e këtyre vendimeve.
- Merr vendime për ndryshimin e statutit qoftë me iniciativën e vet qoftë për t'ju pershtatur legjislacionit Shqiptar.
- Merr vendime për zgjatjen e ekzistencës së Shoqërisë ose mbi ndryshimin e objektit shoqëror.
- Merr vendime për ndryshimin e llojit të Shoqërisë sipas kapitalit shoqëror.

Ç'do ortak ka të drejtë të marrë pjesë me vendimet e marra nga asamblea e ortakëve dhe ka një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit shoqëror që zoterojnë dhe të derdhura rregullisht.



Vendimet e asamblese ne mbledhjen e pare merren me vota qe perfaqesojne shumicen e kapitalit shoqeror, ndersa ne mbledhjen e dyte me shumicen e kapitalit pjesemarres pamvarsisht nga perqindja e kapitalit qe ata perfaqesojne.

NENI 19
MBLEDHJET E ASAMBLESE

Asamblea mbledhet nga nje ose disa ortake qe kane bere kerkese dhe perfaqesojne te pakten 10% te kapitalit te Shoqerise.

Ortaket mund te perfaqesohen edhe nga nje jo ortak qe analizon duke shkruar mbi leter thirrjen e asamblese qe i ka derguar.

Ortaket thirren ne mbledhje me leter rekomanduese ose faks te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dites se caktuar per mbledhjen, ne lajmerimin per mbledhje duhet shenuar dhe shkaku per te cilen mbledhet asamblea (rendi i dites), lajmerimi duhet te behet nga administratori ose eksperti kontabel.

Ne lajmerim c'do ortak ka te drejte te beje pyetje ne perputhje me rendin e dites dhe administratoret do te pergjigjen ne mbledhjen e asamblese.

NENI 20
NDRYSHIMI I STATUTIT

Ndryshimi i statutit behet me vendim te asamblese me aprovimin e ortakeve qe perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise.

Asamblea nuk mund te detyroje ortaket te rrisin kuotat e tyre pjesmarrese ne kapitalin shoqeror ne se ata nuk desherojne.

Keshilli administrativ perbehet nga 5 (pese) antare, tre nga ortaku Shqiptar dhe dy nga ortaku Italian.

Komisioni i eksperteve kontabel prej tre antaresh, dy te emeruar nga ortaku Shqiptar nje nga ortaku Italian.

Emerimi i eksperteve kontabel behet me vendim te asamblese se ortakeve me voten e shumices se thjeshte.

Emertimi i ekspertit kontabel mund te kerkohet me rruge gjygsore nga nje ose me shume ortake qe perfaqesojne 10% te kapitalit shoqeror kur eshte e nevojshme.

NENI 21

Paafesia e njerit prej ortakeve.

Shoqeria nuk shperndahet ne se behet i paafte ose vdes njeri prej ortakeve.

NENI 22

Transformimi i Shoqerise.

Transformimi i Shoqerise behet me vendim unanim te ortakeve ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjor, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur asamblese raporti mbi gjendjen e Shoqerise nga ana e administratorëve. C'do transformim i bere ne kundërshtim me kete nen' eshte i pavlere.

NENI 23

Aktiviteti i Shoqerise ndalon me skadimin e 10 vjeteve nga regjistrimi prane Gjykates se Tiranes ose me pare sipas propozimit te bere prej njerës nga palet kontraktuese atehere kur aktiviteti i ndermarrjes per dy vjet radhazi rezulton jo rentabel ose ne rast kur gjithë ortaket pervec njerit te vetem terhiquen nga Shoqeria dhe ne te gjitha rastet e parashikuara ne aktin e themelimit dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 24

Ne rastin e likuidimit te ndermarrjes zbatohen dispozitat ligjore te ligjes 7638 dt 19/11/1992 me vecorite e poshteshenuara.


Pasunite qe jane vene ne dispozicion te Shoqerise me te drejten e perfitimit i kthehen pronarit ne vendin e tij.

Pasunt financiare si rezultat i veprimtarise se Shoqerise ndahen midis ortakeve ne perpjestim me kuotat e kapitalit te dredhur pasi me pare te jene realizuar pagesat ndaj kreditorëve.

NENI 25
ABITRAZH

Mosmarveshjet e mundshme qe lindin midis paleve, ose midis tyre dhe Shoqerise te cilat nuk zgjidhen me marveshje migesore do te zgjidhen me arbitrazh ne Gjykatën e rrethit Dures sipas ligjeve Shqiptare.

Palet detyrohen t'a konsiderojne vendimin e kesaj gjykate definitiv dhe te pa apelueshem dhe t'a ekzekutoje ate.



ORTAKET

Per NDERMARRJA E KEPUCEVE 2 TE GOMES DURRES

.....
Hamdi Hoxha



Per SIMOD S.p.A

Paolo Gennari
.....
Paolo Gennari

NOTERI

.....
Mito J Dado

